



Pranuar / Dorezuar Punë/Prezantuar Received/Delivered		02.11.2022		2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKANDINAVIA	6659/2022		18		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.956/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.30/2019 të datës 02.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.1101/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative,ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.685/2018 të datës 23.10.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër Vendimit me Nr. 02-070/05-28018/96 të datës 17.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.685/2018 të datës 23.10.2018 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 02-070/05-28018/96 i datës 17.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontrasteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 02/Nr.101/179 të datës 17.01.2012 në pozitën “Përgjegjës i Njësitit së APK-së në Shtime”, Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Shtimes më datë 01.08.2018 ka paraqitura kërkesë për

inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se bazuar në Vendimin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 26.07.2018.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes më datë 28.08.2018 ka nxjerr Vendim me numër 02/1D.Nr.75 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".

Ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, ndërsa ky i fundit më datë 17.10.2018 ka nxjerr Vendim me Nr.02-070/05-28018/96 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 23.10.2018 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 6269/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.12.2018 ka nxjerr Vendim A.nr.685/2018 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin me Nr. 02-070/05-28018/96 të datës 17.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes dhe Vendimin me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 02.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.30/2019 përmes të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar Vendimin A.nr.685/2018 të datës 06.12.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.1101/2021 të datës 15.09.2022 ka refuzuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke e vërtetuar Aktgjykimin A.nr.30/2019 të datës 02.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.30/2019 të datës 02.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.1101/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Ankesën me Nr. Prot: 6269/2018 e datës 23.10.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-070/05-28018/96 të datës 17.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes; Vendimin me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së

Shtimes; Raport për prerjen e pishave i datës 11.07.2018 nga I.Xhemajli; Raport mbi damkimin e shitjes me pakicë në Ng 01 Pishtar e Shtimes i datës 07.06.2018 nga Zyrtari për Mbrojtje dhe Monitorim në DKR të APK-së në Ferizaj; Libri i damkosjes së trungjeve sipas planit për prerje për vitin 2018 nga Agjencia Pyjore e Kosovës; Fletëpërcjellëse me Nr. 004458 e datës 25.06.2018, Nr. 004459 i datës 26.06.2018; Nr. 004460 i datës 29.06.2018; Nr. 004461 të datës 02.07.2018, Nr. 004463 e datës 02.07.2018; Ftesë për seancë e datës 21.09.2018; Ftesë për intervistim për shkelje disiplinore të supozuara me numër 02/1 Nr.60 e datës 03.08.2018; Vendimin me numër 02/1D.Nr.68 të datës 14.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes; Ftesë për intervistim për shkelje disiplinore të supozuara me numër 02/1 Nr.55 e datës 19.07.2018; Ftesë për intervistim për shkelje disiplinore të supozuara me numër 02/1 Nr.59 e datës 01.08.2018; Kërkesë për deklarate e datës 06.07.2018; Kërkesë për pushim vjetor e datës 10.07.2018, 11.07.2018; Raport nga konsulta i datës 25.07.2018, 20.08.2018; Raport i ndërprerjes së përkohshme për punë për periudhën 25.07.2018 deri 20.08.2018; Raport nga ACIBADEM/SISTINA i datës 26.10.2015, 01.06.2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.10.2018; Përgjigjen në ankesë e datës 25.11.2018; Raportin e shkeljes disiplinor të supozuara i datës 01.08.2018 ndaj ankuesit; Procesverbalet e Komisionit Disiplinor i datës 109.08.2018; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave; Procesverbalin e datës 25.09.2018 të Komisionit të Ankesave; Vendim me numër Reference: DQIPGJ-263 i datës 26.07.2018 nga Inspektorati Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Raportin me Nr. 04/19 i datës 12.07.2018 nga Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik e Komunës së Shtimes; Procesverbal për Kontrollimin-Inspektues me Nr. 0168 i datës 05.07.2018; Tabela me pisha të damkosura; Procesverbalin me Nr. 001618 i datës 03.07.2018; Fletëpagesë e me Nr. 010302 e datës 26.06.2018, me Nr. 010303 e datës 05.07.2018, me Nr. 010304 e datës 05.07.2018, me Nr. 010305 e datës 01.08.2018; Deklarate e datës 11.07.2018 nga I.Xhemajli; Dëftesë me Nr. Serik: 063740 e datës 17.09.2018; Fletë dorëzim i datës 28.08.2018 dhe 18.10.2018; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Përgjegjës i Njesisë së Pylltarisë i datës 24.02.2011; Akt Emërimit e datës 17.01.2012 për ankuesin; Gjendjen aktuale të hyrje/daljeve për datës 25.07.2018 deri më datë 20.08.2018 për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 26.12.2017, 30.12.2016; Vendimin A.nr.685/2018 i datës 06.12.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendim A.nr.30/19 i datës 16.02.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në padi e datës 08.03.2021; Ankesën e datës 06.12.2021 për Gjykatën e Apelit të Kosovës; Kërkesën për dalje në teren nga ankuesi për Udhëheqësin e Drejtoratit Rajonal të APK-së Ferizaj me Nr. 63/18 e datës 06.04.2018 nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 02-070/05-28018/96 të datës 17.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes dhe Vendimit me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes, pretendon se: Damkimi është krye si prerje sanitare sipas kërkesë Nr. 63/18 të datës 06.04.2018 i cili ishte

lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës-Drejtori Koordinuese në Ferizaj dhe isha i detyruara të veproj konform kësaj kërkesë; Nuk është marr për bazë deklarata e datës 11.07.2018 e I.Xhemajli e cila është shtrembëruar nga Komisioni Disiplinor; Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave kanë shkel ligjin material sepse vetëm kanë bërë parafrzim të dispozitave ligjore duke mos bërë arsyetim në bazë të provave të lëndës, kështu që masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, në këtë çështje juridike-administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi më datë 06.04.2018 ka dërguar tek Udhëheqësi i Drejtorisë Rajonal të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Ferizaj, Kërkesën për dalje në vend të ngjarjes në ngastrën nr.6-3 me Nr. 63/18, përmes të cilës ka njoftuar se *"sipas rojës I.Xhemajli i cili ka raportuar në vendin e asht quajtur Kulturat e Shtimes te Pishat Ngastra nr.6-3 jane të thata rreth 90 cipa pisha, ku 90% janë në këmb, ndërsa të rrëzuara 10%. Kështu që sipas njoftimit të rojës, po në të njëjtën datë kam dal në vendi të ngjarjes dhe kam konstatu se janë të thata-rrëzuar me rraj me dimensione të ndryshme. Prandaj kërkojmë nga Drejtoria Rajonale APK-së-Ferizaj që të dal në vend të ngjarjes dhe të ndërmarr masat për eliminimin e tyre, për arsye se po priten, po krasiten nga banoret që banojnë afër ketij loacioni. Kështu që roja shumicën e kohës po duhet me qen afër tyre dhe terreni që e ka përsipër po je i pa kontrolluar"*, ndërsa si rezultat i kësaj ka filluar damkimi i drunjëve pishë e bardhë. Më datë 07.06.2018 Zyrtari për Mbrojtje dhe Monitorim në Drejtorinë Koordinues Rajonale të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Ferizaj ka lëshuar raport lidhur me damkimin e shitjes me pakicë në Ng 01 Pishat e Shtimes duke theksuar që ky damkim është bërë sipas kërkesës me Nr. 63/18 të datës 06.04.2018, ndërsa Inspektorati Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës më datë 26.07.2018 ka nxjerr Vendim me numër Reference: DQIPGJ-263 përmes të cilit ka kërkuar që ndaj ankuesit të fillohet procedurë disiplinore për shkak se ka lejuar fillimin e prerjeve të drunjëve të llojit pishë e bardhë pa ndjekur procedurat e nevojshme (vendim nga Drejtoria Komunale për llojin e shitjes, pa u pajisur me kontrata dhe pa emërim të komisionit për pranim dorëzim të ngastrave) përveç një fletëdamkosje të lëshuar nga DKR-Ferizaj më datë 07.06.2018.

Në bazë të raportit me Nr. 04/19 të datës 12.07.2018 të Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, janë prere gjithsejtë 106 pisha prej të cilave 57 copë janë të damkosura nga Drejtoria Koordinuese Rajonale e APK-së në Ferizaj dhe 49 copë janë të padamkosura.

Nga administrimi i të gjitha provave materiale, konstatohet se Kërkesa e datës 05.04.2018 me Nr. 04/3/11 është bërë nga ankuesi për Udhëheqësin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Ferizaj, e njëjta mban vulën e protokollit me Nr. 63/18 të datës 06.04.2018, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit që ka vepruar sipas kërkesës me Nr. 63/18 të datës 06.04.2018 të Drejtorisë Koordinuese Rajonale e APK-së në Ferizaj, është i paqëndrueshëm për faktin që kjo kërkesë nuk është bërë nga Drejtoria Koordinuese Rajonale e APK-së në Ferizaj.

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se lidhur me damkimin e drunjëve pishë e bardhë, të njëjtat janë kryer pa pasur vendim nga drejtoria përkatës komunale, pa pasur kontratë për shitjen e tyre si dhe pa u

formuar komisioni për pranimit dorëzimit të ngastrave, kjo e përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe pikën 1.2.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drunore nga Pyjet Publike, i cili përcakton se: "1.2 Agjencioni Pyjor i Kosovës në bashkëpunim me Autoritetet pyjore komunale mund të marrin vendim...", dhe "1.2.4. Prerja mund të fillojë pas marrjes së kontratës të nënshkruar nga ana e Autoritetit pyjor komunal dhe pagesës në xhirlogarinë bankare", rrjedhimisht prerja është bërë pa u plotësuar kushtet ligjore, kjo mund të vërtetohet edhe në bazë të Procesverbalit me Nr. 001618 të datës 04.07.2018 përmes të cilit komisioni i cili ka dalë në vendin e ngjarjes ka konstatuar se: "me kërkesë të drejtorit të drejtorisë kemi dalë në vendin e ngjarjes ku është konstatuar që në atë lokacion janë prerë 23 cipë pusha pa çekan, 61 cipë me çekan dhe 66 copë tjera janë të damkosura në këmbë por të pa prera, ndërsa në fletëparaqitje janë përcjell 18.5 m³ apo 51 copë".

Nga gjithsejtë 55.46 m³ të prera sipas fletë përcjellëses me Nr. 004458 të datës 23.06.2018 janë paraqitur gjithsejtë 6 m³, sipas fletë përcjellëses me Nr. 004459 të datës 26.06.2018 janë paraqitur gjithsejtë 5 m³, sipas fletë përcjellëses me Nr. 004460 të datës 29.06.2018 janë paraqitur gjithsejtë 2.60 m³, ndërsa sipas fletë përcjellëses me Nr. 004461 të datës 02.07.2018 janë paraqitur gjithsejtë 2.50 m³, ndërsa nga fletëpagesa me Nr. 010302 e datës 26.06.2018 vërtetohet se pagesa është 60 Euro, sipas fletëpagesës me Nr. 010303 të datës 05.07.2012 vlera e pagesës është 50 Euro, sipas fletëpagesës me Nr. 010304 të datës 05.07.2018 vlera e pagesës është 26 Euro, dhe sipas fletëpagesës me Nr. 010305 të datës 01.08.2018 vlera e pagesës edhe 54 Euro, nga kjo rezulton se vetëm 18.5 m³, janë të shitura me fletë përcjellëse dhe fletëpagesë, ndërsa 36.96 m³ nuk janë të shitura me fletë përcjellëse dhe fletëpagesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të theksuarave si më lartë, konstaton se ka pasur shkelje në këtë proces, kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e i cili ka deklaruar se: "...kam qenë prezent më datë 29.06.2018 ditë e premte gjatë prerjes së pishave kemi vërejtur parregullsi, përgjegjësi F. E ka urdhëruar të bëhet prerja e pishave të pa vulosura dhe F. E ka marrë përgjegjësinë për prerjen e pishave, unë meqë kam vërejtur parregullsi lidhur me prerjen e pishave të pa vulosura kamë kërkuar prej përgjegjësit F. E që pishat e pa vulosura të mos prehen...Gjatë prerjes ka ardhur në vendin e ngjarjes Drejtori për Zhvillim Ekonomik F. H i cili ka kërkuar të ndërpritet prerja e të gjitha pishave të vulosura dhe të pavulosura, mirëpo ka hasur në rezistencë nga përgjegjësi F. E i cili ka kërkuar të mos ndërpritet prerja e pishave, pas disa diskutimeve që ndodhën aty u vendos që atë ditë të ndërpritet prerja e pishave", këtë deklaratë z. I.Xhemajli e ka mbrojtur edhe me datë 10.08.2018 në seancën e Komisionit Disiplinor, respektivisht më datë 25.09.2018 në seancën e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, kështu që pretendimi i ankuesit që kjo deklaratë është shtrembëruar është pretendim i pa bazuar.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se para se ankuesit t'i shqiptohet masa disiplinore sipas Vendimit me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes, të njëjtit në bazë të Vendimit me numër 02/1D.Nr.68 të datës 14.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes i është shqiptuar masa tjetër disiplinore "pezullim i shtrimit të detyrave dhe

ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë prej dy (2) muaj”, m arsyetimin se nga data 12.07.2018 deri më datë 01.08.2018 ka munguar në punë.

Lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit sipas Vendimit me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi me veprimet e tij të konstatuar përmes provave të lartcekura ka vepruar në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 1, 3 dhe 4, nenin 52 paragrafi 1 dhe 2, nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në bazë të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: 1.1. shkele e rëndë-serioze e Kodit të Mirësjelljes për nëpunësit civilë; 1.2. vjedhja; 1.3. mashtrimi; 1.4. falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 1.5. ushtrimi i dhunës fizike ose presioni psikik ndaj nëpunësit tjetër civil, palës apo ndonjë personi tjetër brenda institucionit, 1.6. keqtrajtim ose diskriminim i rëndë, 1.7. dëmtim i pronës së institucionit me paramendim; 1.8. diskreditimi dhe komprometimi serioz ndaj nëpunësit civil; 1.9.ardhaja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të drogës ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 1.10.shkelje e detyrave të punës, që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror; 1.11.shkelje serioze të rregullave që ndërlidhen me shëndetin dhe sigurinë e nëpunësit; 1.12.dështimi i deklaramit ose dhënia e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit; 1.13. mosinformimi dhe mungesa e paarsyeshme për dy (2) ditë punë të njëpasnjëshme; 1.14.keqpërdimi apo përdorimi i pa autorizuar i fondeve të besuara publike për përfitime personale ose në interes të personave të tjerë; 1.15. kryerje e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionet apo veprimet që e dëmtojnë institucionin dhe organet e tjera shtetërore; 1.16.sjellja apo kërcënimi që u pamundëson, i pengon apo ua vështiron të tjerëve kryerjen me sukses të detyrave zyrtare të punës; 1.17. mosofrimi i ndihmës profesionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës nëpunësve civilë, funksionarëve publikë dhe palëve, gjatë realizimit të detyrave të tyre ligjore; 1.18.fshejhe e fakteve, provave apo të dhënave zyrtare, kur ato kërkohen për qëllime zyrtare; 1.19. veprim apo mosveprim i cili shpie deri te zbulimi i të dhënave apo informacioneve konfidenciale; 1.20. ngacmim seksual i ndonjë nëpunësit tjetër civil, funksionar publik ose palës, i përkufizuar si sjellje fizike apo verbale e natyrës seksuale, e cila shkel dinjitetin e femrës ose të mashkullit në punë e që është e padëshirueshme ose fyese për personin; 1.21.në qoftëse brenda një periudhe prej një (1) viti i shqiptohen tri (3) vërejtje me shkrim nga udhëheqësi i drejtpërdrejt; 1.22. në qoftëse brenda një periudhe prej një (1) viti i shqiptohen dy (2) vërejtje me shkrim nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit”.* Nga provat e lëndës, Kolegji, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës të ndërlidhura me nën paragrafin 1.1, 1.7, 1.19 dhe 1.15 të nenit 6 dhe paragrafi 2 të nenit 6 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se nëpunësit civilë do t’u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj, siç ka përcaktuar neni 63 paragrafi 1 i këtij ligji, ndërsa lidhur me përgjegjësin për dëmet, neni 65 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se: *“1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara qytetarëve ose institucionit gjatë ushtrimit të detyrës si rezultat i paaftësisë profesionale, neglizhencës së rëndë ose veprimeve të qëllimshme, të paligjshme. 2. Pas përcaktimit të përgjegjësisë, do të bëhet sanksionimi i nëpunësit civil, i cili i ka shkaktuar dëm institucionit ose qytetarëve”,* ndërsa ndërlidhur me këto nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në

respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore, siç parashihet me nenin 64 paragrafi 3 të këtij ligji, ndërsa në rast të shkeljeve të rënda-serioze aplikohen masat disiplinore të përcaktuara me nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil e që janë: *pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor.*

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për faktin që në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen disiplinore të bërë nga ankuesi, po ashtu në mënyrë të drejtë dhe në proporcion me shkeljen ka shqiptuar edhe masën disiplinore, duke vepruar kështu në pajtim me kompetencat e përcaktuara me nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 13 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ndërsa masa ndaj ankuesit është shqiptuar në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Andaj edhe pretendimi i ankuesit kundër këtij vendimi është i pabazuar sepse Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes përveç konstatimit të shkeljeve disiplinore që ka bërë ankuesi ka marrë parasysh edhe masat e tjera që ka pasur ankuesi duke iu referuar Vendimit me numër 02/1D.Nr.68 të datës 14.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në ankesën e datës 23.10.2018 të parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në faqen 2 pasuesin e 6 ndër të tjera thekson se: *"konsiderojmë që gabimisht është shënuar data 28.18.2018 dhe në fakt është fjala për datë 28.08.2018"*, në këtë rast Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes sipas Vendimi me Nr. 02-070/05-28018/96 i datës 17.10.2018 ka bërë lëshim teknik duke iu referuar datës së nxjerrjes së Vendimit me numër 02/1D.Nr.75 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor. Ndërlidhur me këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 02-070/05-28018/96 i datës 17.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontrasteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes është nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe Ankesave, sepse kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe poashtu drejtë kanë konstatuar bazën juridike, andaj edhe pretendimet e ankuesit lidhur me këtë vendim janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese në seancë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative se për të njëjtin rast nga Prokuroria Themelore në Ferizaj janë pushuar hetimet për dyshimtë kryerjes së veprës penale, Kolegji për shqyrtimin dhe

vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia disiplinore, këtë e ka përcaktuar neni 63 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Përgjegjësia personale për kryerjen e një vepre penale ose kundërvajtje gjatë ushtrimit të detyrave administrative nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit civil, me kusht që vepra gjithashtu të përbëjë shkelje të detyrës, siç është përcaktuar me këtë ligj”*, andaj në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Bazuar në Aktgjykimin A.nr.30/2019 të datës 02.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.1101/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke marrë për bazë vërejtjet e adresuara në këto aktgjykime dhe që janë obligative për kolegjin e këshillit, ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë dhe të hollësishme pretendimet ankimore të ankuesit dhe në mënyrë meritore ka vendosë në lidhje me ankesën si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.956/2021, datë 02/11/2022.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.